



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. 06-40933 2023

Klinë, 27.11.2023

### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e punës së Kuvendit të Komunës të mbajtur me datë 27 Tetor 2023 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Pjesëmarrës në mbledhje është kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj, nënkryetarja e Komunës, znj. Marqe Selmani, përfaqësuesi i policisë, drejtorë të drejtorive, media lokale dhe qytetarë dhe nxënës të dy shkollave të mesme të komunës së Klinës.

Mbledhjen e hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi i cili konfirmoj se prezentë janë 25 anëtarë të Kuvendit. Për Rendin e Ditës, kryesuesi tha se ka një kërkesë nga kryetari i Komunës për një pikë shtesë.

z. Esat Raci, tha se është dakord me pikën shtesë por kërkon që në të ardhmen materiali për mbledhjen e kuvendit të vijë sipas rregullores me kohë.

z. Zafer Gashi pasi përshëndeti të gjithë për rendin e ditës tha se tek pika e 9 ka ardhë një listë por nuk është lista e kërkuar nga grupi i LVV. Është kërkuar lista e përfituesve për dëmet që janë bërë nga vërshimet. Kemi marrur listën e atyre që nuk janë kompensuar, ne do ti votojmë mjetet që janë ndarë për kompensim por kërkojmë që deri të vjen kjo pikë e rendit të ditës, administrata të na sjell listën e kërkuar.

Kryesuesi tha se shërbimi i kuvendit e ka pyetur për këtë listë por ai ju ka thënë sepse nuk ka nevojë atë listë sepse atë listë e kanë të gjithë prej kur është votuar në kuvend. E ka parë të arsyeshme që të jua dërgoj listën e vetëm atyre që nuk kanë përfituar akoma nga shuma prej 86000 eurove të ndara.

z. Kushtrim Haliti tha se ai si anëtar dhe kryetar i komisionit për emërtimin e rrugëve dëshiron të informoj se dy anëtarë të këtij komisioni znj. Xhyle Halili dhe z. Shani Toqani nuk kanë marr pjesë në këtë komision. Xhyla ka marr pjesë fillimisht por tani është jashtë vendi ndërsa Shani Toqani nuk ka marr pjesë asnjëherë. Kërkoj që të i zëvendësojmë këta dy anëtarë, tha z. Haliti.

Për këtë propozim kryesuesi tha se të mbetet për në pikën e fundit – të ndryshme.

**Me 25 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim u Miratua Rendi i Ditës me shtesat e theksuara.**

**Pika 1 e Rendit të Ditës: Arsytimi i mungesave**

Mungon vetëm Ilir Hoti dhe Blerta Gashi. Ilir Hoti është jashtë vendit ndërsa Blerta Gashi pritet që të i bashkohet mbledhjes së shpejti

**Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.**

**Procesverbali u miratua pa asnjë votë kundër dhe abstenim, pa asnjë vërejtje.**

**Pika 3 e Trendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të KPF-së.**

Kryesuesi tha se pjesa dërmuese e këtyre rekomandimeve janë në rendin e ditës përveç tre kërkesave të orientuara, dy në drejtorinë përkatëse dhe zyrën ligjore dhe një në zyrën e kryetarit.

Me propozimin e shefave të grupeve kuvendare që të vihen në votim në bllok, kryesuesi e nxori në votim dhe me 25 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUAN

**Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i raportit të menagjimit financiar janar-shtator 2023.**

**z. Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Përshëndetje. Fillimisht dua të i përmend tri çështje të rëndësishme. 1. Dua të falënderoj komplet kuvendin e komunës për votimin e buxhetit, më vota unanim. 2. Planifikimi i buxhetit për vitin 2023 është realizuar në javën e parë të muajit tetor dhe është tejkaluar. Kjo ndodhë për herë të parë që të realizohet në fund të muajit shtator. Dhe 3. Në një takim të mbajtur në nivel ministror me përfaqësues të komunave, komuna e Klinës është vlerësuar si komuna më e mirë në nivel Kosove sa i përket mbledhjes së mjeteve nga tatimi në pronë.

Drejtoi i financave, z. Enver Berisha në vazhdim lexoi raportin në detaje.

#### **Hapet Debat**

**z. Arben Limanaj:** Përshëndetje të gjithëve. Në raportin buxhetor shihet përmirësim i realizimit në krahasim me vitin e kaluar. Dëshiroj ta pyes drejtorin, tek kapitalet janë shpenzuar vetëm 40%, që të fitoj grandin komuna duket që nuk jemi afër realizimit të dëshiruar. Shihet që janë rritë shpenzimet për telefonin vala. Po ashtu krahasuar me vitin 2022 ka rritje në kategorinë e drekave dhe shpenzimet e luksit ti quajmë kështu. Kërkojmë kujdes në të ardhmen me këto shpenzime.

**Znj. Besiana Gashi:** Përshëndetje. Në lidhje me këtë raport unë po ju referohem me kode ekonomike. 31520- shuma në vitin e kaluar ka qenë rreth 20 mijë euro. Më intereson gjithashtu kodi 13501 që të dy kodet kanë tematikë të njëjtë. Cila është diferenca mes këtyre dy kodeve? Mendoj se rritja gjatë këtij viti është shumë e madhe. Dëshiroj të kem informacion edhe për kodin 14050 ku rritja është diku 10 mijë euro nga viti i kaluar, çka hyn në këtë pjesë dhe si arsyetohet rritja e shpenzimeve në këtë kod. Kodi 13509, diferenca me vitin e kaluar është më e vogël pro më intereson cilat janë ato që shkruhet Pajisje të tjera. Gjithashtu kodet e tjera që kanë të bëjnë me dreka, provizion etj, kërkoj sqarime dhe për pjesën e kodit ekonomik 13610 çfarë hynë në këtë kod? Po flasim për shuma të mëdha dhe shpenzime të panevojshme.

**z. Enver Gashi:** Përshëndetje të gjithëve. Falënderoj drejtorin e financave për raportin e detajuar. Por dua të ndalëm në krahasimin e këtij raporti me vitin paraprak. Nëse e bëjmë këtë shihet që trendi i uljes është evident dhe na gëzon të gjithëve. Por kjo nuk do të thotë që është arritur maksimumi pasi që në disa kategori ka rritje të shpenzimeve. Është shumë shqetësuese se çdo vit kemi rritje tek kategoria e shpenzimeve për gjrobat e gjykatave që kërkoj nga ekzekutivi që edhe më shumë ta ruajnë paratë publike.

**z. Zafer Gashi:** Faleminderit drejtor për raportimin. Shihet që në strat që pjesa më e madhe e ekzekutivit dhe kryetarit është plotësuar. Ka të bëjë më grandin që është dominues dhe është më i madhi në %. Drejtoi përmendi edhe shumën e të hyrave vetanake që është rritur, është shumë e mirë kjo e arritur. Kur jemi të shpenzimet, janë pagat dhe mëditjet, dhe ju thoni se ka të bëjë me ligjin e ri të pagave, rritjen e koeficienteve por ne kemi kërkuar dhe kemi marrë një listë me 13 emra që mendoj se nuk janë përfshi gjitha me zyrtar të punësuar. Jeni duke bërë gara me kate, i dyti dhe i treti për punësime familjare. Po kaloj tek kodet e shpenzimeve. Nr. 11. Kodi 50026 Sa janë marrë taksa për legalizim, vetëm 6737 euro, kemi pa një lajmërim se vazhdohet ky afat për legalizim, pyetja është a duhet përsëri të aplikojnë njerëzit edhe ata që kanë aplikuar në mënyrë që të rriten të hyrat e komunës. Tek tabela 1141, e kam thënë edhe herët e kaluar se anëtarësimi në oden e mjekëve dhe infermiereve, një vend keni 1770 euro dhe një vend tjetër 1120 euro që keni paguar. A mund të më sqaroj dikush se a janë paguar këto mjete nga buxheti komunal sepse mua mjeket dhe infermierët më kanë thënë se kanë paguar që në shkurt nga llogaria e tyre personale. Ndër vite shoh blerje të mobileve, karburantet për vetura keni bërë mirë që e keni ulur pak shpenzimin. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve-2300 në muaj shpenzime kur i ndajmë shpenzimet. Prej 15.144 euro për vitin 2022 janë 21.168 këtë vit. Nëse i llogarisim për vitin 2022, 2023, 2024, 2025 do të hargjohen më shumë se 72 mijë euro shpenzime për këto mirëmbajtje dhe riparime. Shumë e çuditshme. Kodi 1450, qershia mbi tortë-mirëmbajtja e pajisjeve dhe mobileve, çka d.m.th. kjo? Me çka i pastroni këto mobileje? Prej 20.041 euro janë 31.190 euro. Ndaluni pak dhe mendoni, këto janë para të qytetarëve dhe nuk është normale çdo muaj 3.465 euro për me i pastruar mobilet. Për dy vjet 52.231, për katër vjet 104.231 mijë euro. Ndërtimi i e- administratës kodi 31120 nuk e diji çka d.m.th. Parqet nacionale pastaj a mos keni dashtë me thënë parqet publike. Aktet gjyqësore, borgjet që ju keni pasur njerëzve, ju përgëzoj për pagesat e tyre.

Kryesuesi tha se sa për sqarim Kodet janë sistem financiar, terma unik në krejt republikën e Kosovës. Ai tha gjithashtu se ka një lutje që krahas shpenzimeve mos tu ju hyjmë në hak qytetarëve nëse nuk përmenden edhe të hyrat e shtuara 633 mijë e 395 euro më shumë të hyra nga qytetarët tanë.

**z. Valmir Bacaj:** Sa i përket këtij raporti, fillimisht dua ta falënderoj stafin e drejtorisë së financave për një raport të detajuar. S ai përket rritjes së të hyrave vetanake është meritë e qytetarëve të cilët i falënderoj shumë. Sa i përket shpenzimeve ne mund të i përmendim edhe ato që janë zvogëluar si ato tek shpenzimet e karburanteve, udhëtimet zyrtare, shpenzimet e vendimeve të gjykatave etj. Rritja e disa shpenzimeve vet rritja e buxhetit nënkupton edhe rritje të shpenzimeve. Po ashtu siç e thatë edhe ju kryesues, kur jemi tek përshkrimi i shpenzimeve siç është ajo e mirëmbajtjeve të mobileve nuk nënkupton vetëm mirëmbajtje të mobileve por është term më i gjerë.

**z. Kolë Prenaj:** Përshëndetje të gjithëve. Mua më inkurajoj ky raport, e përgëzoj drejtorin me bashkëpunëtor. E kam obligim që ta falënderoj edhe ish drejtorin Aziz Deskun e ndjerë që ka lënë një trend të mirë të financave të komunës. Don zoti e ky trend rritet çdo vit e më shumë në vetëdijesimin e qytetarëve në pagesat e tyre dhe rritjen e të hyrave vetanake. Mendoj që edhe investimet duhet të shtrihen më shumë në fshatrat ku qytetarët janë më të rregullt në pagesat e obligimeve të tyre e këtu vlen të theksohet Gremniku gjithsesi. Falënderoj kryetarin e komunës bashkë me kryesuesin që kanë qenë mjaft transparent por gjithsesi Opozita ka të drejtë të kritikoj. Kërkoj që shoqëria civile të jetë me aktive në të ardhmen dhe unë në fund vetëm dua që të ju përgëzoj për punën e bërë.

**z. Tunë Dedaj:** Përshëndetje të gjithëve. Dua të ndalem vetëm tek një aspekt. U fol për rritjen e të hyrave vetanake. Qytetarët e kanë parë që qeveria punon mirë për ta dhe jua kthen mjetet e tyre në investime kapitale. Dua ta falënderoj Enverin dhe gjithë stafin. Sa i përket Opozitës, Opozita nuk ka punë tjetër përveç se me kritiku ose me gjetë ndonjë gabim. Për këtë i falënderoj kur gjejnë gabime.

**z. Kushtrim Haliti:** Para se me ja nisë na kritikove neve opozitës kryesues që nuk po i përmendim të arriturat. Ne si opozitë jemi për me kritiku opozita është për me u lavdëru. Nuk ju kemi faj pozitës që ka asamblistë që dy vjet nuk ka folur asnjëherë. Sa i përket shpenzimeve në shëndetësi në vitin 2023 janë 144 mijë e 628 euro ndërsa në vitin 2022 janë vetëm 16 euro. Diferenca është e madhe. Pastaj furnizimi me ushqim, diferenca afër 40 mijë euro, furnizimi me rrymë gjenerator 70 mijë euro këtë vit ndërsa në vitin 2022 është zero. Qiraja e tokës nuk e dimë se çfarë qiraje. Objektet kulturore 3740 euro këtë vit, vitin e kaluar nuk ka pasur, ku është ky investim? Tek mbeturinat po ashtu 30 mijë euro është diferenca. Tek Shëndetësia, mbrëmë kam qenë në shtëpinë e shëndetit, çdo vit investohet aty por gjendja është katastrofë, banjat etj. Shtretërit me shumë gjakë etj.

Kryesuesi tha se ne qytetarët e mbushim arkën e komunës dhe është mëkat nëse nuk e përmendim .

**z. Esat Raci:** Dëshiroj rreth këtij raporti të flas por më bëni përshtypje Enveri dhe Kola që përmenden votimin e buxhetit edhe nga opozita. Ne e kemi votuar këtë buxhet pa asnjë listim dhe për hatër të qytetarëve sepse vërejtjet tona, propozimet tona nuk janë marr asnjëherë për bazë. Dy shembuj konkret: urdhëroni dhe shkoni shikoni rrugën Afrim Haliti, ose rrugën Volljak- Sferklë. Unë dje nëpër dy rrugët kam qenë dhe të dy rrugët janë të dëmtuara.

**z. Armend Beqiri:** Dëshiroj të ndërlihem me fjalën e mësuesit të nderuar që tha se ka asamblistë që nuk kanë folur asnjëherë. Unë e përgëzoj opozitën për kritikën e tij por gjithashtu ankoem sepse të arriturat asnjëherë nuk i përmendin.

**z. Kushtrim Haliti:** Rruga që u përmend "Afrim Haliti" si ka dy javë që është shtruar dhe është në gjendje të tmerrshme, kanë nisë tani që të prejnë asfaltin dhe ta riparojnë, Le të urdhërojnë opozita dhe le ta shikojnë vet dhe do ta kuptojnë që nuk është roli ynë vetëm të kritikojmë por ta themi të vërtetën.

**z. Esat Raci:** Dëshiroj të ja bëjë me dije asamblistit opozitar që në këto dy mandate roli ynë si opozitar nuk ka qenë vetëm të kritikojmë por kur ka qenë mirë edhe kemi përkrahur dhe kemi votuar.

**Znj. Arta Pantina:** Përsëndetje. Dëshiroj të kyçem tek shtëpia shëndetësore dhe ti them drejtorit të shëndetësisë se është rëndë me thënë nuk është hotel por është spital sepse është drejtor i shëndetësisë dhe me qenë spitali në atë gjendje nuk është mirë.

**z. Ndrec Zefaj:** Përsëndetje të gjithëve. Në lidhje me raportin financiar shumë shkurt dua të them se realizimi i të hyrave që po thuhet me mburrje nga drejtori dhe pushteti, kemi thënë edhe më herët se arkën e Komunës e mbushim me tatimin në pronë dhe për këtë duhet të falënderojmë qytetarët e Komunës. Kur thuhet se 40% e buxhetit është realizuar nga totali, nëse thuhet me mburrje, ju them se nuk është në përmasat e kënaqshme. Edhe një çështje që e ngriti Tunë Dedaj që tha se opozita e kanë punë që të kritikojnë, kjo casje nuk është e drejtë sepse qëllimi i yni është për të mirën e qytetarëve dhe sidomos nuk duhet harruar se një pjesë e kësaj opozite e ka sjell në pushtet këtë parti politike.

**z. Tunë Dedaj:** Faleminderit Ndrec kur na ke përkrahë për të ardhë në pushtet, Aleanca nuk i ka nda me shtëpia sipas përkatësisë politike, ti e dinë më së miri sepse ta kemi sjell asfaltin në derë. Unë kam qenë në opozitë dikur dhe e kam përkrahur pozitën kur ka punuar mirë. Unë vet kam me shkuar me i pa ato dy rrugë që i përmendi asamblisti dhe nëse është ashtu kam me kërkuar që mos të pranohen ato dy rrugë dhe të mos ju paguhen mjetet.

**z. Valmir Bacaaj:** Kam një lutje për të gjithë asamblistët që të rrijnë në rendin e ditës. Sa i përket asaj që tha kolegu Ndreca, Unë thash se buxheti është realizuar në më të mirën e mundshme , këtë e bëra krahasuar me vitin e kaluar. Ndërsa sa i përket realizimit të shohim deri në fund të vitit.

**z. Esat Raci:** Dua të i propozoj edhe një pounë tjetër Tunës, të shkoj përveç në ato dy rrugë edhe në Gjyrgjevik të Madh tek Fatmir Berisha dhe e sheh se si është bërë ndarje politike.

**z. Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Falënderoj të gjithë asamblastët që u bënë pjesë e këtij debati. I vetëdijshëm që kam qenë pjesë e asamblesë komunale 4 mandate dhe është mirë secili pozitë apo opozitë të ndjejë peshën e vet që e ka në përfaqësimin e qytetarëve. Kam bërë përpjekje dhe kam bërë një sqarim tjetër pasi që tek kodet është hapësirë e limituar. Sa i përket drekave, nuk ka asnjë ndryshim më të madh apo më të vogël përveç një vizite që ka bërë presidentja e Kosovës me 30 veta staf. Tek % e kapitale që theksoi Arbeni, kjo % që është tani jemi të vetëdijshëm që është e ulët por gjithashtu e dimë se sa projektet e mëdha janë duke u realizuar dhe çfarë kuotash kemi, prandaj as nuk dyshojmë fare që do ta realizojmë. Shpenzimet gjyqësore janë shumica të bartura vit pas viti. Të hyrat vetanake është e vërtetë që ka një vetëdije më të madhe të qytetarëve por është angazhim i veçantë i zyrtarëve të drejtorisë në publikimet dhe njoftimet, për një pjesë kemi shkuar edhe me përmbarues. Pra është një iniciativë e jona që ne e kemi marruar për herë të parë që e ka përsheptuar pagesën e obligimeve. Mbeturinat, diferenca është rreth 36 mijë euro, e kam sqaruar edhe më herët, 31 mijë euro i kemi paguar të administratës komunale dhe 5 mijë euro të drejtorisë së arsimit për vitin e kaluar. Çështja e rrugëve, Volljak dhe "Afrim Haliti". Rrugën Sferkë- Volljak mbrëmë kam shkuar në Bubël dhe e kam parë është një nga rrugët më të mira që ka Klina, nuk e ka asnjë vërejtje. Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit, janë sqaruar por prap po përsëritet pyetja, janë transporti i nxënësve, dhe është ritë shkak i borgjeve të vitit të kaluar. Tek Pajisjet me kompjuter, këtë nuk është dashtë ta thoni sepse fjala është për blerjen e lllaptopëve për juve.

Drejtori Berisha në vazhdim shpjegoj ne detaje të gjitha shpenzimet që asamblastët i theksuan si të rritura duke lënë që [pjesën e shëndetësisë të përgjigjet drejtori i Shëndetësisë.

z. Enver Berisha tha në fund se në total këtë vit janë shpenzuar mjete më pak.

**z. Agron Bacaj, drejtor i Shëndetësisë:** Po i përgjigjem z. Zafer Gashi për dy pyetjet e tija fillimisht. Anëtarësia e mjekëve dhe infermierëve në odat përkatëse. Shpenzimet që të kanë treguar ty infermierët dhe mjekët është pagesë për rilicensim, ato paguhen individualisht. Pyetjet e Zafit i marr me sportivitet sepse nuk ka qenë në pushtet e kur të vjen në pushtet mund të punoj më shumë për shëndetësinë por kur më vijnë nga PDK me duken interesant. Këto temat e shëndetësisë që lidhen me PDK i kemi sqaruar një herë me Esat Racin. Kushtrimit më duhet me ja dhënë disa përgjigje. Sa i përket Shtretërve dhe çarçafëve në QKMF, më vjen mirë dhe jam krenar që të vetmen vërejtje që ju mund at jepni është për shtretërit dhe çarçafët. Ka gjak në çarçaf dhe dysheku është i vjetër. Po është e vërtetë, krejt këto do të ndërrohen gjithsesi por shiko se janë 9 tualete të rinovuar dhe asi tualete nuk mund të i shikosh në asnjë institucion. Për Artën, hotelin e përmenda për shkak të mirëmbajtjes jo në ndonjë kontekst tjetër. Në QKMF gjatë natës funksionon qendra e emergjencës ku pranon raste të ndryshme e edhe me gjakderdhje ku gjatë natës nuk ka mundësi që të ndërrohen ata çarçafë pasi që kompania e pastrimit e nisë punën në mëngjes. Kushtrimit i propozoj që ta vizitoj një vend për me e pa maskarllakun e qeverisë së PDK, vizitoje ambulancën ne Ujmir ku ka me milion barna të skaduar që ju kanë skaduar qeverisë tuaj dhe është lëndë e shqyrtimit të prokurorisë. Neve na duhen që të paguajmë mijëra euro që të i asgjësojmë ato. Dallimi në mes neve dhe juve është se neve mund të na kritikoni për çarçafë e shtretër ndërsa nuk mund të na kritikoni për skadim të barnave e as sepse ne kemi nxjerr pajisje të reja që donacionet e dhëna i keni nxjerr jashtë QKMF , tek ne donacionet mbesin brenda QKMF-së.

**z. Zafer Gashi:** I nderuar drejtor, Edhe një herë , për herë të dytë po më thoni se anëtarësimi ndalet në paga. Licenca nuk bëhet çdo vjet. Unë kam informacion nga njeriu që e njihni edhe ju se ata i

paguajnë vet anëtarësimet. Sa i përket për barnat me skadencë është e vërtetë që duhet paguar edhe të asgjësohen. Tubimi i tyre në Ujmir është bërë sepse ka qenë një furrë djege atje donacion, prandaj i kanë grumbulluar aty. Ka pasur barna që janë gjetur edhe me afat. Sa i përket çarçafëve të gjakosur e kuptoj se është emergjenca dhe mund të ndodhë por duhet ta dini për infeksionet dhe duhet mirëkuptuar Kushtrimin, duhet të ndërrohen çarçafët.

**z. Arta Pantina:** I nderuar drejtor nuk e diji pse i merrni gjerat personale. Të gjithë qytetarët e Klinës marrim shërbime në QKMF dhe kur nuk është në rregull duhet pranuar.

**z. Kushtrim Haliti:** Kërkoj nga Agroni që të përgjigjet me butë sepse nuk i tutet askush askujt. Unë nuk jam inspektor që të i shikoj barnat e skaduara, sidoqoftë që 6 vjet janë në pushtet pse nuk i ka rregulluar ato punë.

**z. Agron Bacaj, drejtor i Shëndetësisë:** Kushtrim kur të duash mund të thërrasësh interpelancë dhe të i sqarojmë të gjitha rastet veç e veç. Kur kam qenë në opozitar nuk jam marrë me çarçafë, kam trajtuar tema të tjera të rëndësishme, barnat që kanë hy dhe kanë dalë nga QKMF. Fola për barna të skaduara të hedhura në Sferkë, të bartura në Ujmir aty janë hermetikisht të mbyllura, ka pasur edhe barna me afat të gjetura e të hedhura. Sa i përket tonit, ky është toni im skam çka me ba.

**z. Esat Raci:** Nuk jam i kësaj lëmie por atë që e tha Kushtrimi, që 6 vjet është dashtë të iniciohet procedura për asgjësimin e tyre. Unë ndjehem krenar që kam qenë pjesë e ekzekutivit të PDK dhe kemi bërë shumë punë të mira që ato i prekni ju çdo ditë. Sa i përket prokurorisë në lidhje me barbat e skaduara, prokuroria nuk ka gjetur asnjë shkelje nga Komuna. Ndërsa ju akoma nuk jeni në gjendje të bëni një orar kujdestarie për barnatoret.

**z. Agron Bacaj, drejtor i Shëndetësisë:** Sa i përket Orarit të Barnatoreve kujdestare, ka qenë përpjekje e jona në kohë pandemie e cila një kohë ka funksionuar por më pastaj është ndalë. Komuna e Prishtinës e ka bërë një orar të tillë por ka pengesa ligjore sepse po kontestohet nga Agjensioni i produkteve medicinale të cilët licencojnë barnatoret dhe të cilët e kanë përsipër të organizojnë oraret e barnatoreve gjatë natës. Sa i përket barnave të skaduara dhe hetimeve të prokurorisë e diji që është mbyllur rasti dhe pikërisht shkaku i kësaj nuk kemi mundur që të marrim masa për asgjësim, para se të mbyllet kjo çështje.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Përshëndetje të gjithëve. Debatet u tejkaluan ndoshta në disa raste sa i përket trajtimit të një raporti financiar. Besoj ën shumicën e shqetësimeve u përgjigj drejtori i financave dhe besoj që u dhanë shpjegime. Sidoqoftë, një gjë që Agroni harroj të përgjigjet, është një kod që ka ndryshuar. Është e vërtetë që ne jemi bashkë opozitë dhe pozitë që të ju shërbejmë qytetarëve dhe shqetësimet e juaja janë edhe të mijat, edhe shqetësimi i çarçafëve që shumë shpejt do të ndërrohen. Kur është fjala tek projektet kapitale, rrugët që theksuan Esati dhe Kushtrimi, rrugët kanë garanci 1 ose 2 vjet. Edhe rruga "Afrim Haliti" që është shtruar rishtas, kompania ka për obligim që ta sanoj defektin, edhe autostradat që kanë kushtuar me miliona euro kanë defekte që sanohen. Janë disa terrene që kanë lagështi të madhe dhe gjatë verës thahet toka prandaj edhe mund të ndodhë që të çahen asfaltet. Ne jemi duke i ndërtuar rrugët me një shtresë etj. dhe kanë këto defekte, Besoj që drejtori i urbanizimit i ka marr shënime dhe do të marr masat e duhura që të sanohen këto defektet.

Pasoj një replikë dhe kudnërreplikë mes z, Zafer Gashit dhe kryesuesit z. Fadil Gashi që nuk u arritë të kuptohet tema.

**Pika 5 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit nga drejtoria për financa dhe zhvillim për shtim buxhetit dhe krijimin e kodit të ri për fasadimin e objekteve në qytet, faza e tretë.**

**z. Arben Limanaj:** A është fjala për objektin që është duke u fasaduar tani apo për objekte të tjera?

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Fjala është për fasadimin e objektit tek furra Pashtriku.

**Me 20 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 6 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit nga drejtoria e financave për shtim të buxhetit dhe krijimit të kodit të ri për fasadim të objekteve të vjetra në qendër të qytetit.**

**Me 22 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 7 e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për shtim të mjeteve**

**Me 22 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 8 e Rendit të Ditës: Shqyrtim i dhe aprovimi i propozim vendimit për ndarje të mjeteve financiare për pagesën e dëmeve të pa paguara për vërshimet e vitit 2022**

**z. Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Ne bashkërisht e kemi marrë një vendim për pagesën e dëmeve të vërshimeve për fund vitin 2022 dhe për ato që nuk kemi mundur ti paguajmë ka ardhur tani kjo listë tani për pagesë. Mos pagesa është bërë shkak i mos kompletimit të dokumentacionit të kërkuar dhe tani është edhe një listë shtesë e atyre familjeve që nuk janë vizituar në rundin e parë. Për këto dy kategori e kemi sjell në kuvend që të marrim aprovimin tuaj. Shuma që duhet kompensohen këto familje është 13 mijë e 846 euro.

Kryesuesi tha se e ka vendimin që e ka nxjerr kjo asamble në vitin e kaluar dhe e lexoi në vazhdim atë vendim.

**z. Tunë Dedaj:** Dua të falënderoj të gjithë ata që janë angazhuar që këtyre qytetarëve të jua kryejmë obligimet. Kam një kërkesë që të i bëjmë apel qeverisë që të paguajnë dëmet nga vërshimet fundit të cilat akoma asnjë person nuk i ka marrë.

**z. Esat Raci:** jemi plotësisht dakord që këto pagesa të bëhen. Pyetja e njëjtë që bëri Tunë Dedaj, çka është bërë me kompensimet e dëmeve të vërshimeve të fundit. Në seancën e kaluar unë pata propozuar që të hiqet ndonjë projekt kapital dhe të bëhen pagesat.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Komisioni Komunal për hartimin e dëmeve të vërshimeve e ka kryer raportin dhe e ka dorëzuar në qeveri dhe sa e diji unë qeveria ka marr vendim për kompensim të dëmeve të viti 2022 dhe akoma jo për ato të vitit 2023 ku shumë komuna sikurse ne jemi në pritje.

**z. Zafer Gashi:** Ne kemi kërkuar që të vije lista me përfituesit e dëmeve nga vërshimet e para. Ne fillimisht e kemi pas marrë një listë më pastaj ditën që është mbajt mbledhja na ka ardhur një listë tjetër e pa protokolluar dhe buxhet i rritur. Pse nuk mund ta kemi listën e përfituesve dhe të shohim se si janë kompensuar në detaje. Po flasim për dëmet dhe përfituesit e dëmeve nga vërshimet e vitit 2022, atë listë e kemi kërkuar ne.

Kryesuesi tha se në vendimin e vitit 2022 është cekur ndarja lineare të vlerës, 30%. Dhe në atë seancë është kërkuar që të inkorporohet lista shtesë.

**z. Arben Limanaj:** Dëshiroj që të shtroj si pyetje, a ekziston mundësia ligjore që mjetet që mbetin në fund të vitit të i destinohet për pagesën e dëmeve të vitit 2023

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Ne kemi edhe dy tre ditë sa na ka mbetë kohë për realizimin e zotimeve për projekte kapitale, është e pamundur bartja nga kategori tjetër. Është e mundur vetëm pagesa nga subvencionet ku kemi kohë edhe pak. Unë besoj që Qeveria ka me marr vendim për pagesat gjithsesi.

**z. Valmir Bacaj:** Listën që e kemi përpara prej 16 vetave dhe bizneseve është pjesë përbërëse e listës që e kemi votuar si kuvend por që kanë mbetur pa paguar për shkaqe që i sqaroj drejtori. Sa i përket vërshimeve të dyta në vitin 2023, komisioni dhe ekzekutivi e ka kryer punën e vet dhe presim që qeveria të përgjigjet pasi që komuna nuk ka buxhet që të kryej këto kompensime.

**Me 20 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRTUA lista dhe shuma e caktuar/**

Pika 9 e Rendit të Ditës: Raportim në lidhje me listën e përfituesve...

**Pika 10 e Rendit të Ditës: Raportim në lidhje me vitin e ri shkollor 2023-2024**

**z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA:** Të nderuar të pranishëm. Fillimit të vitit të ri shkollor sa i përket drejtorisë së arsimit dhe Komunë i jemi përgjigjur me përgatitjet e duhura. Ishte një lajm shumë i mirë se viti shkollor po niste me 1 shtator duke pasur parasysh se një vit më parë nuk nisi ashtu. Nuk jemi lajmëruar fare për ndryshimin për furnizim me tekste mësimore. Edhe kur kemi pasur furnizim nga MASHT me tekste mësimore kemi pasur [probleme e la më tani me rimbursimin e prindërve. Kjo ishte shumë shqetësuese sepse edhe nisem me 1 shtator, mungesa e teksteve krijoj shumë probleme. Në takimin që kam pasur me drejtorët e shkollave kam kërkuar që mësimdhënësit të jenë afër prindërve dhe nxënësit mundësisht të furnizohen me librat ekzistuese nga vitet e kaluara. Një muaj ditë ka qenë afati nga ministria për rimbursim e që ky rimbursim ka shkuar jo mirë. Ka pasur vështirësi nga prindërit që të aplikojnë në ueb faqe. Një numër telefoni në dispozicion nuk ka funksionuar fare. Tani në këtë kohë furnizimi i nxënësve me libra është e mirë diku 95% e tyre janë të furnizuar por ky furnizim nuk është si veprimtari e rimbursimit nga ministria. Para fillimit të vitit shkollor kemi investuar në shumë shkollë duke rinovuar banjat, ndërruar kaldajat dhe zëvendësuar ato me ngrohje termike. Sa i përket sezonit të dimrit drejtorja e arsimit është e përgatitur dhe jemi në rregull me procedurat e tenderimeve. Jemi duke u munduar që të instalojmë tabelat e mençura që ka qenë edhe [premtim i kryetarit e të cilat tabela do të zëvendësojnë llaptopët etj. Për herë të parë në Shkollën e mesme kemi hapur qendrën e karrierës që nuk ka ekzistuar më parë. Jemi duke pritur një udhëzim nga Masht që do ta rregulloj listën e pritjeve dhe të mos kemi humbje të orëve në të ardhmen.

**z. Arben Limanaj:** Falënderoj drejtorin e arsimit për informatat e dhëna. Dua të di se a ka drejtorja e arsimit ndonjë plan për shkollat që po rrezikojnë të mbyllën shkaku i numrit në rënie të nxënësve. Më gjithë këtë drejtorja vazhdimisht hap konkurse për kuadro të reja. Është një formulë në ministri që përcakton se sa nxënës duhet të ketë një mësues. Po ashtu një çështje shumë shqetësuese është se që dy vite drejtorja e arsimit po vonohet në furnizimin e arsimtarëve me ditar pune.

**z. Qemajl Sejdiu, Drejtor i DKA:** Faleminderit. Fillimisht në Komunën e Klinës nuk ka shkollë që nuk ka klasë të parë. Nëse bëjmë krahasime, këtë vit janë 82 nxënës më pak që krahasuar prap por me komuna të tjera ne qëndrojmë shumë mirë. Në Komunën tonë janë dy shkollë që janë në rrezik të



mbyllen, në Resnik dhe në Kernicë. Ne si DKA do të menaxhojmë me këto shkolla dhe me stafin e tyre. Sa i përket konkurseve që përmendet, kombinimi i klasave nuk preferohet sepse nuk ka dhënë rezultate prandaj ne jemi të detyruar që të pranojmë kuadro të reja. Për ditaret e punës për mësimdhënës, është kërkuar nga ne që të mos bëjmë furnizimin por kjo do të bëhej nga ministria e në fund na kanë lënë prap neve në kompetencë prandaj është bërë kjo vonesë.

**z. Enver Gashi:** Falënderoj drejtorin e DKA për informacionet e dhëna. Kam një pyetje për drejtorin, Pse nëpër shkolla nuk ka internet?

**z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA:** Po është e vërtete, gjendja është e tillë si arsye e dështimit të procedurave të tenderimit, nuk kemi pasur kompani që të aplikoj.

**z. Zafer Gashi:** Një sqarim nëse ka mundësi. Ne si asamblistë kemi paralajmëruar disa drejtor të shkollave se do të i vizitojmë si arsye e disa problemeve që veçse u thanë këtu. Diku nga 8 shkolla ne jemi pranuar vetëm nga drejtori Gani Ahmetxhekaj të cilin e falënderojmë për pritjen. Shqetësimi ynë është mos pranimi ynë nga drejtorët e tjerë. Dëshiroj të dijë nëse ka paraqitë problem kjo për juve, vizita e dy asamblistëve nëpër shkolla?

**z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA:** Për çdo aktivitet nëpër shkolla duhet bërë një kërkesë në DKA që kjo e fundit të jetë e njoftuar me veprimtaritë dhe qëllimin e vizitës paraprakisht. Meqë se ke nisë me i vizituar shkollat mirë bëni që të shkoni të vizitoni çerdhen të” ura e Haxhisë”, pasi që e keni edhe pushtetin, shkoni bëni disa foto dhe dërgojani ministrisë së arsimit që ta shohin se si ka mbetur pa përfunduar projekti i tyre. Po ashtu edhe shkollën e re në Grabanicë që po ndërtohet dhe të shihni cilësinë e punimeve, edhe kjo është punë e qeverisë. Ndërsa vizita nëpër shkolla, po mund të bëhet ashtu siç ju thashë më herët sepse shkolla ka rregulla.

**z. Zafer Gashi:** Ne kemi bërë kërkesë edhe në shkollën e Grabanicës, ndërsa sa i përket çerdhes tek Ura e Haxhisë është një problem dhe zgjidhja është e nevojshme. Ne do ta iniciojmë zgjidhjen e këtij problemi por kryetari duhet të jetë i vendosur se ku dëshiron ta ndërtoj Çerdhen. Vizita e jonë nëpër shkolla nuk ka qenë politike.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Po e plotësoj pak drejtorin e DKA. Vizitë pa kërkesë paraprake në DKA ka të drejtë të bëjë vetëm anëtarët e komitetit për arsim.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Në lidhje me çerdhet , unë e kam bërë me transparencë me vendim të kuvendit.

**z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA:** Unë e pata fjalën për çerdhen e ndërtuar dhe pa përfunduar tek “Ura e Haxhisë” jo për çerdhen që mendohet të ndërtohet. Dokumentacionin e kërkuar nga komuna i kemi dërguar të gjitha.

**Znj. Arta Pantina:** Dëshiroj të bëjë pyetje: Pajisjet kompjuterik në shkollën e mesme “Luigj Gurakuqi” mungojnë, përveç kësaj ka persona që nuk dinë me e përdor word-in, si drejtori dhe sekretari, që ta kthejnë një email ose ta shkruajnë një dokument. Nuk e dijë cilat janë kushtet për pranim të një drejtori ose sekretari.

**z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA:** Sa i përket pjesës së fundit, drejtorët e sekretarët nuk i kam zgjedhë unë, është komisioni që i ka zgjedhë. Nëse ata nuk dinë ta përdorin teknologjinë nuk mund të quhen analfabet. Shumë gjenerata të vjetra i kemi të arta por ata nuk e njohin teknologjinë. Sa i përket kabinetit të informatikës e kemi marr me vonesë kërkesën për furnizim por do të kompletohet ai kabinet gjithsesi.

**z. Armend Beqiri:** E falënderoj drejtorin për sqarimet. Sa i përket vendimit të ministrisë për mos furnizim me tekste mësimore por të behët rimbursimi i prindërve, gjatë implementimit të këtij vendimi kanë dalur probleme në aplikimin për fëmijët e moshës 6 vjeçare. A është rregulluar ky problem nga ministria e arsimit. Po ashtu gjatë aplikimit online e-Kosova a ka pasur staf që i ka ndihmuar prindërit. Po ashtu dua të dijë nëse keni informacion të saktë a është bërë rimbursimi total për tekstet mësimore.

**z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA:** Problemi i fëmijëve të moshës 6 vjeçare ka ekzistuar në fillim dhe akoma vazhdon të jetë. Deri me tani nuk kemi asnjë informacion se në çfarë % është kryer rimbursimi.

**z. Esat Raci:** Unë kam një falënderim dhe dy pyetje në formë kërkesë. Përgatitja për ngrohje nëpër shkolla këtë vit është në rregull dhe ju falënderoj. Pajisje higjienike dhe sportive ka mungesë të mëdha nëpër shkollat e komunës së Klinës.

**z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA:** Po është e vërtetë që kemi pasur problem me kontratat për higjienë. Për të dy problemet që i përmendet kemi kontrata por ka munguar kërkesat e menagjmentit të shkollave. Këto probleme tani më janë zgjidhur.

**z. Kushtrim Haliti:** Unë kam një kërkesë që ka mundësi tek shkolla e Gjurgjevikut të sjellët një bager për të pastruar vendin para se të prishet koha.

**z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA:** Po është kritikë me vend dhe besoj që do at rregullojmë.

**z. Tunë Dedaj:** Drejtor dua të të falënderoj për zgjidhjen e mirë që ke bërë me instalimin e pompave termike dhe ke siguruar ngrohjen për shkolla. Dua të falënderoj ministritë e përparshme që kanë marr vendim për furnizim me tekste mësimore nxënësit dhe ajo që ka qenë gabimi më i madh është i kësaj qeverisë së fundit që ka vendosë për kompensim përmes rimbursimit.

**z. Arben Limanaj:** Kam një kërkesë për pozitën, që të kursehen pak se mbarun duke falënderuar njeri tjetrin. Në lidhje me atë që pyeta më herët për mbylljen e shkollave. Ne si grup nuk jemi për mbylljen e shkollave por si DKA duhet të bëjë një analizë më të thellë sepse ka edhe shkolla amë që kanë nën 100 nxënës dhe të gjitha këto shkolla amë që kanë nën 100 nxënës mund të mbyllen.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Ne jemi të vetëdijshëm që të gjitha komunat e Kosovës përveç qendrave të mëdha do të jenë para një sfide të vështirë sepse me zvogëlimin e banorëve, zvogëlohet edhe buxheti, edhe personeli. Regjistrimi që pritet të bëhet së shpejti mendoj që do të na prek shumë sepse me siguri do të ketë zvogëlim të banorëve.

**Znj. Lirie Gashi:** Përshëndetje. Kam një shqetësim, tek shkolla "Ismet Raci" klasat kanë numër të madh nxënësish. Sa është në rregull nëse në një klasë janë 41 nxënës.

**z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA:** Nuk ka klasë me 41 nxënës të paktën në klasa të para. Tani janë gjenerata të më hershme që kanë pasur por që tanimë nuk mund të i ndajmë e ti shpërndajmë nëpër klasa. Rregullorja është respektuar më shumë se sa herëve të tjera gjithsesi.

**z. Valmir Bacaj:** Në bazë të shqetësimeve të ngritura në Kuvend shihet se gjendja në arsim është shumë e mirë. Nëse shqetësim i vetëm është tek mungesa e internetit dhe kushteve në edukatën fizike, atëherë është mirë puna në arsim. Shumë punë të arsimit në nivel lokal janë të lidhura ngushtë me ato të nivelit qendror e kur e kemi parasysh se ministrinë e arsimit e udhëheq njeriu që ka bërë 10 vjet që të diplomoj në master atëherë më të vërtete i kemi punët mirë në arsim.

**z. Qendrim Millaku, drejtor i ShP:** Përshëndetje të gjithëve. Lidhur me raportimin e qenve endacak në komunën tonë posa ka përfunduar kontrata 2021-2022. Planifikimin për vitin 2023 bashkë me kryetarin e kemi rritur shumë e buxhetit. Menjëherë pas lidhjes së kontratës ne kemi filluar me trajtimin e qenve endacak në qendër të qytetit dhe lagjet përreth si dhe fshatrat ku ka pasur kërkesë. Deri në fund të këtij muaji numri i trajtuar i qenve ka shkuar në 130. Ky problem është në të gjithë Kosovën por ne të paktën jemi munduar që të merremi me këtë problem.

**z. Tunë Dedaj:** Drejtor faleminderit për informacionet. Kjo që është duke u bërë deri tani është shumë pak por e diji që nuk keni buxhet më shumë. Me kastrim të qenve nuk është e mundur që të ndalohet që të dëmtohen qytetarët. Uroj që do të bëhet një zgjidhje tjetër për qentë endacak, të ndahet buxhet shtesë qeveria dhe të grumbullohen në vende të caktuara duke jua mundësuar qytetarëve lirinë për të ecur nëpër rrugë.

**z. Qendrim Millaku, drejtor i SHP:** Eliminimi i qenve endacak është i ndaluar dhe buxheti ynë për trajtim tjetër është i mangët. E kemi rritë shumë nga 20 mijë në 30 mijë euro. Në fund të vitit të kaluar ministria e pushtetit lokal e ka hedh në diskutim publik strategjinë e trajtimit të qenve me dhe pa pronar por nuk e diji se deri ku ka shkuar kjo strategji.

**Pika 12 e Rendit të Ditës: Miratimi i marrëveshjes ndër komunale mes Komunës së Klinës dhe asaj të Skenderajt.**

**Me 19 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.**

**Pika 13 e Rendit të ditës: Kërkesa për plotësimin e anëtares në komisionin për emërimin dhe ri emërimin e rrugëve dhe vendbanimeve.**

**Kuvendi u pajtua që anëtarja e deritanishme, znj, Xhyle Halili të zëvendësohet me një person tjetër të propozuar nga shoqëria civile.**

**Pika 14 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe përgjigje**

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Kam një kërkesë për drejtorin e administratës. A ka mundësi që kompania e cila na furnizon me material të mos e leje zyrën e kryesuesit me prit tre muaj për një toner? Janë shumë të papërgjegjshëm dhe neglizhentë ata të asaj kompanie. Është një kontratë e centralizuar nga niveli qendror e diji. Janë disa banalitete që kanë krijuar me centralizimin e kontratave nga niveli qendror që nuk po mund të durohen. Zgjidhje me të keqe s' kanë pas mundësi që ta bëjnë.

**z. Binak Sylaj, drejtor i administratës:** Përshëndetje të gjithëve. Këto që i tha kryesuesi janë prezente jo vetëm në Klinë por në të gjitha komunat që aknë punë me këtë kompani. Krejt çka mundemi me bërë ne është që ne të ju drejtohem me vërejtjet e tona përmes zyrës së prokurimit. Kemi pasur gjatë kohës së diasporës shumë probleme me dokumente dhe i kemi bërë vërejtjet tona. Nëse kemi mundësi me e shkëputë kontratën, jemi në përpjekje me zyrën e prokurimit.

**z. Kushtrim Haliti:** Për drejtorin e bujqësisë, Punëtorët – rojat e pyllit a dalin ndonjëherë në teren që të shohin se a po behët dëme nëpër pyje. Po ashtu drutë që shiten nëpër rrugë a i kontrollon ndonjë inspektor për prejardhjen e druve që shesin. Po ashtu pyetje tjetër për drejtorin e inspektoratit. Pse tek rreth rrotullimi Peje- Prishtinë nuk ka tabela informuese, shenja të komunikacionit?

**z. Lorenc Marleku, drejtor i Bujqësisë:** Shqetësimin e njëjtë e kemi edhe ne. Rojet e pyjeve i ruajnë pyjet nuk aknë të drejt që të shohin e inspektojnë stoqet e druve që shiten, Kjo është kompetencë e agjencionit pyjor të Kosovës. Janë goxha të përziera kompetencat. Këtë javë i kemi gjithsejtë tre gjoba

nga rojet e pyjeve. E kemi një vakum tash e 6 muaj por është aprovuar ligji që të gjithë pylltarët të kalojnë në kuadër të agjensionit pyjor të Kosovës.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Në ligjin për vetëqeverisje lokale tek kompetencat e deleguara , neni 18.1-F thotë : Mbrojtja e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës, në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror duke përfshirë dhënien e licencës dhe prerjen e drunjëve në bazë të rregullave të miratuara. Kjo është kompetencë që na e aknë deleguar niveli qendror neve në nivel lokal. Me këtë ligj nuk e kanë të drejtën e menaxhimit të pyjeve dhe drunjëve agjensioni në fjalë, Nëse duan me e ndryshuar këtë kompetencë ju duhet at ndryshojnë edhe këtë dispozitë të ligjit.

**z. Faruk Smajli, drejtor i inspektoratit:** rreth rrotullimi Prishtinë-Klinë-Pejë është në menaxhim të ministrisë. Ne vazhdimisht ju kemi bërë shkresa duke ju bashkangjitur edhe fotografi. Me datë 12 të muajit ët fundit i jam drejtuar së fundmi duke i bashkangjitur edhe foto nga aksidentet por akoma nuk ka asnjë ndërhyrje.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Javën e ardhshme do at vendosim një dritë aty ne vet si komunë.

**z. Zafer Gashi:** Që ta them, se kur është mirë unë e them. E mirëpres vendimin e kryetarit që ai rreth rrotullim të bëhet me dritë ashtu siç e ka rregulluar hyrjen e qytetit. Puna e ndërrimit të gypave të asbestit është duke u bërë mirë.

**z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit:** Përhëndetje. Prita këtë pikë që të përgjigjem. Rruga “Ymer Berisha” tani më kanë nisur punimet dhe kemi marr përsipër që të ndërrojmë gypin kryesor të furnizimit me ujë të pijshëm dhe po ashtu gypin e asbestit ta heqim nga shfrytëzimi. Telashin më të madhe e kemi me KEDS që nuk është bashkëpunues sa duhet. Legalizimi është duke vazhduar, informimi ynë për qytetarët nuk mungon. Ata që kanë aplikuar një herë për legalizim nuk aknë nevojë të aplikojnë serish. Një çështje tjetër . Rruga në Gjurgjevik të madh, Fatmir Berisha nuk ka dashur që të i shtrohet rruga.

**z. Enver Gashi:** Kemi një kërkesë për dy lagje në Sferkë dhe për fshatin Dush e Qupevë për ndriçimin publik. Kur do të nisë projekti nëpër këto vende?

**z. Qendrim Millaku, drejtor i SHP:** Ne kemi filluar me zgjerim të rrjetit në Cabiq do të vazhdojmë në fshatin Zabërgjë, pastaj në lagjen e Morinëve dhe mbarojmë për këtë vit sepse kemi vetëm 97 mijë euro.

**Znj. Lirie Gashi:** Për drejtorin e shëndetësisë: Pse QKMF nuk ka gjinekolog apo gjinekologe?

**z. Agron Bacaj, drejtor i Shëndetësisë:** Ne jemi në përpjekje që të angazhojmë një gjinekolog. Shpresa është që mjekët e rinj që kanë marr specializimin gjinekolog kur ta përfundojnë të vijnë dhe shërbejnë në QKMF. Deri atëherë do ta angazhojmë një gjinekolog.

**z. Tunë Dedaj:** Dua ta përkrahu dhe falënderoj Kushtrimin për shqetësimin e vjedhjes së drunjëve. Nuk ka më lehtë se të gjendët hajni. Mjafton atyre që shesin dru në qytet të ju shkohet dhe pyetën se ku i keni marr drutë.

**z. Lorenc Marleku, drejtor i Bujqësisë:** Është absurde me shku pylltari me e pyet shitësin se ku i ka pre drunjët. Nuk ka drejt ligjore. Agjensioni pyjor dhe inspektorët e ministrisë janë përgjegjës. Pylltarët tanë e kanë përgjegjësi vetëm ruajtjen e pyllit.

Kryesuesi duke falënderuar të gjithë për pjesëmarrje dhe duke i uruar detyrën drejtorit të ri të kadastrit z. Nikson Dakaj, i mbylli punimet e kësaj seance të asamblesë komunale.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryesuesi:

Fadil Gashi

